



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
VLORË

Nr. 584 Regj. Them.
Datë 26.12.2012

Nr. 584 Vendimi
Datë 28.12.2012

VENDIM
PER CAKTIMIN E MASES SE SIGURIMIT PASUROR

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë e përbërë nga:

GJYQTAR: ERVIN TRASHI

dhe sekretare gjyqësore *Edita Mataj*, sot në Vlorë, më datë 28/12/2012, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore, kërkesën penale me Nr. 584 Akti, që i përket kërkesës për gjykim me:

OBJEKT:

Caktimin e masës së sigurimit pasuror "Sekuistro Preventive" për pasurinë Nr. 17/1/2, Zona Kadastrale 8602, regjistruar në Z.R.P.P. Vlorë.

KËRKUES:

Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, përfaqësuar nga Prokurori [REDAKTUAR]

BAZA LIGJORE:

Neni 274 i Kodit të Procedurës Penale.

Gjykata pasi shqyrtoi dhe mori provat, në përfundim të shqyrtimit, pasi dëgjoi konkluzionet përfundimtare të prokurorit, si dhe pasi shqyrtoi dhe analizoi çështjen dhe provat e paraqitura:

VËREN

Se, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, më datë 26.12.2012 ora 14.30 është sjellë për gjykim, pranë kësaj gjykate, kërkesa për caktimin e masës së sigurimit pasuror "Sekuistro Preventive" për pasurinë Nr. 17/1/2, Zona Kadastrale 8602, regjistruar në Z.R.P.P. Vlorë.

Nga studimi i akteve në dosje ka rezultuar se, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë, ka regjistruar procedimin penal Nr. 1995 viti 2012 për veprën penale të "Falsifikim i dokumenteve", "Shpërdorimi detyrës" dhe "Pastrim i produkteve të veprës penale", parashikuar nga nenet 186/2; 248 dhe 287 të Kodit Penal.

Nga aket shkresore të ndodhura në dosje rezulton se në Z.R.P.P.Vlorë është regjistruar pasuria Nr. 17/1/2 Zona Kadastrale 8602 në favor të Z. [REDAKTUAR]. Ka rezultuar se dokumentacioni është paraqitur prej shtetasit [REDAKTUAR]. Ky shtetas rezulton të ketë dorëzuar midis të tjerash edhe shkresën Kthim Përgjigje të A.K.K.P. Tiranë Nr 4392/1 prot; datë 13.08.2012, sipas të cilës rezulton se në këtë insitucion ndodhet dosja nr 101/1 datë 24.07.1993 në emër të subjektit të shpronësuar [REDAKTUAR].

Prokuroria pretendon se kjo shkresë është e falsifikuar, pasi në këtë datë (13.08.2012) Z. [REDAKTUAR] nuk ka qënë në detyrën e Drejtorit të A.K.K.P. Tiranë.

Në dosje ndodhet edhe një vërtetim pronësie që mban datën 14.03.1995, me vulë të Hiptekës Vlorë, sipas të cilës rezulton se pasuria prej 1.5 vreten në vëndin e quajtur "Uji i Ftohtë Vlorë" në kufizime përkatëse, ndodhet e regjistruar në nene 162 të vitit 1939.

Nga kqyrja që është kryer prej oficerit e policisë gjyqësore rezulton se në nene 162 të vitit 1939, nuk ndodhet e regjistruar pronësi në emër të [redacted] por është një notë transkriptimi në favor të [redacted] kundra [redacted]

Në dosje rezulton të jetë administruar edhe një notë transkriptimi e paraqitur prej shtetasit [redacted] nene 4 Vol IX 1939. Kjo notë transkriptimi nuk ka asnjë ekstremitet vulë apo nënshkrim dhe nuk rezulton se nga cili institucion ka dalë.

Në vijim të hetimeve ka rezultuar se nota e transkriptimit, nene 4 vol IX viti 1939 dyshohet të jetë e falsifikuar, pasi ajo rezulton të jetë në favor të [redacted] për pasurinë dyqan e ndodhur në Nartë Vlorë. Sipas indeksit alfabetik të pasurive të regjistruara në Z.R.P.P.Vlorë, nuk rezulton që subjekti [redacted] të ketë në pronësi pasuri të regjistruar.

Prokuroria është duke kryer hetime lidhur me këtë procedim penal, në ngarkim të shtetasit [redacted] për veprën penale të falsifikimit të dokumenteve dhe pastrimit të produkteve të veprës penale, parashikuar nga nenet 186 dhe 287 të Kodit Penal. Njëkohësisht është duke kryer hetime dhe ndaj jursites që ka pranuar këtë dokumentacion për veprën penale të shpërdorimit të detyrës, parashikuar nga neni 248 Kodi Penal.

Për sa sipër, nga ana e organit procedues ekziston dyshimi i arsyeshëm se, dipsonimi i lirë i kësaj pasurie do të mund të lehtësonte kryerjen e veprave të tjera penale nga i dyshuari si dhe mund të kalonte në tjetërsimin e saj.

Gjykata vëren se neni 274 i Kodit të Procedurës Penale përcakton se:

1. Kur ka rrezik që disponimi i lirë i një sendi që lidhet me veprën penale mund të rëndojë ose të zgjasë pasojat ose të lehtësoj kryerjen e veprave penale të tjera, me kërkesën e prokurorit, gjykata kompetente urdhëron sekuestrimin e tij me vendim të arsyetuar.
2. Sekuestroja mund të vendoset edhe për sendet, produktet e veprës penale dhe çdo lloj pasurie tjetër që lejohet të konfiskohet, sipas nenit 36 të Kodit Penal.
3. Kur ndryshojnë kushtet e zbatimit, gjykata me kërkesën e prokurorit ose të të interesuarit, e heq sekuestron.

Nga interpretimi literal i kësaj dispozitë rezulton se masa e sigurimit pasuror sekuestro preventive mund të vendoset në rastet kur disponimi i lirë i një sendi që lidhet me veprën penale mund të rëndojë ose të zgjasë pasojat ose të lehtësoj kryerjen e veprave.

Referuar rastit konkrete duke qënë se dyshohet të jetë regjistruar një pasuri në mënyrë të kundërligjshke, atëherë është e nevojshem vendosja e masës së sigurimit sekuestro preventive, me qëllim eliminimin e mundësisë së tjetërsimit të kësaj pasurie në persona të tjerë.

PËR KËTO ARËSYE

Gjykata, bazuar në 379 e vijues, nën 274 të Kodit të Procedurës Penale

VENDOSI

1. Pranimin e kërkesës.

2. Caktimin e masës së sigurimit pasuror "Sektstro Preventive" për pasurinë Nr. 17/1/2, Zona Kadastrale 8602, regjistruar në Z.R.P.P. Vlorë.
3. Urdhërohet Policia Gjyqësore të realizojë ekzekutimin e këtij vendimi.
4. Një kopje e këtij vendimi i dërgohet Z.R.P.P. Vlorë me qëllim kryerjen e shënimit në regjistrin përkatës.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Vlorë brenda 10 ditëve, duke filluar ky afat nga dita e njoftimit të këtij vendimi.

U shpall sot, në Vlorë më datë 28.12.2012.

GJYQTAR

ERVIN TRASHI



07 cv 203

